



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:020735
Datë: 29.10.2024
Numri i dokumentit: 06363403

C.nr.771/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.S nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E.H, avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilan, me objekt kontesti kompensimi në emër të kualifikimit, inflacionit në pagë, shpenzimet e ushqimit dhe shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 1,986.83 euro, jashtë seancës, me datë 14.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.S nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilan, që në emër të kualifikimit bachelor për periudhën kohore Tetor 2021 – Janar 2023, për 16 muaj, duke llogaritur nga 55.35 euro për çdo muaj, t’ia paguaj paditëses shumën prej 885.60 euro, në emër të inflacionit vjetor për periudhën kohore Tetor 2021 –Nëntor 2022 (duke marrë për bazë pagën bazë të paditësit prej 421.00 euro), t’ia paguaj shumën prej 580.13 euro, dhe në emër të kompensimit për ushqimin ditor për periudhën kohore 11.10.2021 – 21.11.2022, për 255 ditë pune, duke llogaritur nga 2 euro në ditë, t’ia paguaj paditëses shumën prej 386.00 euro dhe për të njejtën periudhë në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, duke llogaritur 70 %, të vlerës së biletës së trafikut urban, t’ia paguaj paditëses shumën prej 135.10 euro, apo shumën e përgjithshme prej 1,986.83 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 09.01.2024, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuares së saj, më datë 09.01.2024 ka paraqitur padi, kurse me datë 19.09.2024, ka paraqitur parashtresë për rregullin e kërkesëpadisë në këtë gjykatë kundër të

paditurës për kompensimin në emër të kualifikimit, inflacionit në pagë, shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të udhëtimit, në vlerë të kontestit prej 1,986.83 euro.

Në padin e dt.09.01.2024, dhe parashtresen e dates 26.09.2024, ka theksuar se e njëjta është e punësuar në Shkollën Filllore e Meseme të Ulët (në vijim: SHFMU) “Skenderbeu” në fshatin Përlepnice Komuna e Gjilanit, në cilësinë e mësime dhënëses. Përkundër kualifikimit të saj bachelor, asnjëherë nuk është kompensuar për aq sa e përcakton baza ligjore për kualifikim nga e paditura si punëdhënëse, edhe pse ky ka qenë detyrim i së njëjtës. Për periudhën kohore nga muaji Tetor 2021 –Janar 2023, e njëjta është kompensuar vetëm në shumën prej 58.32 euro për çdo muaj, ndërsa është dashur të paguhet në shumën prej 113.67 euro (sipas 27 % të pagës bazë), me ç’rast e paditura i ka mbetur borxh në shumën prej 55.35 euro në muaj, po ashtu nuk ka bërë kompensimin për inflacionin në pagë bazuar në entin e statistikave në Republikën e Kosovës për periudhën kohore Tetor 2021 –Nëntor 2022 në shumën prej 580.13 euro, si dhe për shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore nga data 11.10.2021 –22.11.2022, në shumën prej 386.00 euro dhe për shpenzimet e udhëtimit në shumë prej 135.10 euro. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 41.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të kualifikimit/licencës, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie punë tek e paditura dhe për periudhën kohore nga dt. 11.10.2021-21.11.2022 ka gjithsej 193 ditë të pranisë në punë (fakt i vërtetuar nga vërtetimi nr.prot.177/1 i dt.20.11.2023, i lëshuar nga SHFMU “Skenderbeu” në Përlepticë K.Gjilan, si dhe kontrata e punës në kohë të pacaktuar së paditëses me të paditurën, nr.prot.304 e dt.01.09.2021, nr.prot.263 e dt.01.09.2022, nr.prot.219 e dt.01.09.2023).

Sa i përket vendbanimit të paditëses, e njëjta ka sjellur provë (siekstrakti nga regjistri civil E 60519734 e dt.07.10.2024, me të cilën vërtetohet se vendbanimin e ka në Gjilan), e as nuk është kontestuese se bileta njëdrejtimëshe Gjilan-Përlepticë, është 0.50 euro (fakt i vërtetuar nga vërtetimi lëshuara nga SHTU “Anamorava” Gjilan).

Nuk është kontestuese se e njëjta ka diplomë të nivelit bachelor nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Edukimit (fakt i vërtetuar edhe nga diploma nr.5588 e dt.07.06.2021), dhe se pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 58.32 euro (fakt i vërtetuar edhe nga lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses nga BRK).

Sa i përket shkallës së përqindjes të inflacionit, gjykata nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës ka gjetur se kjo përqindje për vitin 2021 është prej 3.4 %, dhe për vitin 2022 është prej 11.6 %.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendës drejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, në nenin 3, paragrafi 2 është përcaktuar se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel

të vendit dhe kësaj kontrate”; neni 35, paragrafi 5 se “Punëtorët arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës së caktuar, i paguhen 70 % të biletës së trafikut urban; dhe neni 35, paragrafi 7 se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 euro (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit të kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”, neni 35, paragrafi 10 përcakton se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga kjo, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me bachelor, pasi është paguar në shumën prej 58.32 euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 113.67 euro, me ç’rast i ka mbetur borxh në shumën prej 55.35 euro, ndërsa periudha e kërkuar për këtë kompensim përfshin kohën sa ka qenë në fuqi Vendimi i Qeverisë dhe nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 09.01.2024, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga maji Janar 2021. Po ashtu, gjykata ka gjetur se paditësja ka provuar se gjatë periudhës sa kanë qenë në fuqi të dy kontratat kolektive ka kërkuar kompensimin sipas shkallës së inflacionit, ndërsa ky kompensim arrin lartësinë e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sipas shkallës së llogaritur nga enti i statistikave (neni 35.10 i KKAK). Ndërsa, lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket shpenzimeve të ushqimit, gjykata e vërtetoi nga fakti se për shpenzimet e ushqimit nga 2 euro në ditë, për 193 ditë në total, arrijnë vlerën prej 386.13euro, dhe për shpenzimet e udhëtimit për 70 % të çmimit për dy drejtim të biletës (1.00 euro) arrijnë vlerën prej 135.10 euro, të llogaritura si në nenin 35.5 të KKAK-së

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim, kurse me pretendimin e të paditurës se inflacioni nuk mund të kërkohej vetëm në një sektor të punës, gjykata vlerëson se me kontratë kolektive është përcaktuar se inflacioni ka ndikim në pagën e mësimdhënësve, prandaj edhe këtë pretendim e gjeti të pabazuar.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë

procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.771/24, më datë 14.10.2024

Gjyqtarja,
Edona Zuzaki

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.